VENDIM
Nr.62, datë 3.10.2006

PËR PËRCAKTIMIN E KOHËZGJATJES SË PERIUDHËS TRANZITORE DHE TË SASISË SË FATURIMIT AFORFE PËR KLIENTËT FAMILIARË QË NUK JANË TË PAJISUR ME MATËS TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9, 26, pika 1, dhe 52, pika 3, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", ndryshuar me ligjin nr.9512, datë 10.4.2006, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 3.10.2006, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "KESH" sh.a. për përcaktimin e kohëzgjatjes së periudhës tranzitore dhe të sasisë të faturimit aforfe për klientët familiarë që nuk janë të pajisur me matës të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Afati i aplikimit të faturimit aforfe për klientët familiarë që nuk janë të pajisur me matës të energjisë elektrike do të jetë deri më 31 mars 2007.
2. Sasia e faturimit aforfe do të mbetet e njëjtë në përputhje me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.48, datë 21.10.2004.
3. Ky afat i aplikimit të faturimit aforfe për klientët familiarë që nuk janë të pajisur me matës të energjisë elektrike, shtohet në licencën nr.34 të furnizimit me energji elektrike dhënë "KESH" sh.a. me vendimin nr.11, datë 23.2.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
4. Ngarkohet shoqëria "KESH" sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta